

## **Hapet thirrja për bursa për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në programin Erasmus + në Universitetin e Paviors, në Itali.**

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në Universitetin e Paviors, në Itali, për semestrin e dytë të vitit akademik 2022-2023.

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimi i stafit akademik për mësimdhënie në fushën e Shkencave Sociale;
- Shkëmbimi i stafit akademik për trajnim në fushat: Biomedic Physics radiation protection, Chemistry, Engineering.

### **Kohëzgjatja e bursave:**

- (5 ditë + 2 ditë udhëtim);

### **Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin ditor (160 EUR në ditë për stafin);
- Kostot e udhëtimit (275 EUR).

### **Procedura e aplikimit kryhet online.**

- Kandidati i interesuar përzgjedh një pedagog nga departamenti respektiv në Universitetin e Paviors për të shprehur interesin për të kryer një periudhë shkëmbimi duke dërguar përmes e-mail CV e tij/saj për të treguar fushën e ekspertizës dhe si të dy universitetet mund të përfitojnë nga ky aktivitet. Ju mund të gjeni të dhënat e kontaktit në adresën e website <https://web.unipv.it/strutture-e-infrastrutture-di-ricerca/dipartimenti/>  
Për Departamentin e Shkencave Sociale - Prof. Marco Missaglia;  
Për Biomedic Physics radiation protection, Chemistry, Engineering - Prof. Elio Giroletti.
- Kandidati duhet të plotësojë dokumentin “Mobility agreement” duke u konsultuar me pedagogun e përzgjedhur mbi aktivitetet që do të zhvillojë gjatë periudhës të shkëmbimit.
- Kandidati duhet të plotësojë aplikimin online në adresën:

<https://internazionale.unipv.eu/en/erasmus-teaching-staff-from-extra-eu/>

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim:**

- CV;
- Dokumenti “Mobility agreement” i firmosur nga aplikanti, nga departamenti i Universitetit të Paviors dhe Universiteti i Tiranës;
- Kopje të pasaportës;
- Vërtetim punësimi të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze / italiane;

*\*\* Mobility agreement për stafin akademik është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat, i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus + dhe nga Universiteti i Pavis.*

**Nga ana e universitetit pritës janë vendosur 3 afate:**

- 10 shkurt 2023, ora 12:00 (mesditë);
- 31 mars 2023, ora 12:00 (mesditë);
- 2 maj 2023, ora 12:00 (mesditë).

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin Tuaj!